



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NTP Lulishtja Bucaj" të datës 16.01.2016 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i këndeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunën e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NTP Lulishtja Bucaj" të datës 16.01.2016 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i këndeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunën e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NTP Lulishtja Bucaj" (tutje "parashtruesi") me datë 16.01.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i këndeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunën e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimet ankimore: AK në kuadër të pozicionit nr. 23 të Specifikave Teknike (ST) në kuadër të Dosjes së Tenderit (DT) ka përcaktuar kërkesën si në vijim:

Furnizimi, transporti dhe montimi i shportës -sipas dimensioneve minimale:

Dimensionet gjenerale Ø: 500 mm H: 820 mm V: 70 L

Pjesa nga betoni Ø: 500 mm H: 790 mm δ: 60 mm

Kapaku metalik: Ø: 500 mm H: 225 mm δ: 3 mm

Pjesa e mbrendshme e ndarë në tri pjesë V:22 L δ: 1 mm -elektroegalvanizuar , Pjesa e mbrendshme për cigare në një pjesë V:0,4 L δ: 1 mm.


Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të stampuar. Përzierja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj). Me mbulesë Varnish-gloss sipas standardit EN 1504-2).

Rezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004)

Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019.


Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021.

Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.



Kjo kërkesë si e tillë është në kundërshtim me nenin 7 lidhur me nenin 28 të LPP për faktin që forma por edhe dimensionet e këtij produkte janë fikse dhe nuk është lejuar aspak tolerancë apo ekuivalencë. Konkretisht përmes nenit 28 par. 7 të LPP përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë". Në rastin konkret ky produkt në formën sikurse është formuluar kërkesa më sipër nënkupton se është pikërisht artikulli i veçantë siç ndalohet në dispozitën e lartcekur. Tutje përmes nenit 28 par. 7 të LPP përcaktohet se "nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët -ose ekuivalent-". Në rastin konkret AK jo vetëm që nuk ka lejuar ekuivalencën sipas dispozitës së lartcekur por edhe dimensionet i ka përcaktuar fikse pa lejuar aspak tolerancë.

Vlen të shtohet po ashtu se poz. 23 i ST/DT si i tillë është edhe kundërthënësi pasi që dimensionet e përcaktuara në tekstin e pozicionit nuk përputhen me dimensionet e përcaktuara në figurën e pozicionit. Si shembull në tekst thuhet që lartësia duhet të jetë 820mm ndërsa në figurë lartësia e shportës është 101.50mm. Ngjashëm edhe gjatësia kapakut në tekst kërkohej të jetë 225mm ndërsa në figurë është 160mm.



Për këto arsye, kërkojmë nga AK që të ndryshoj/plotësoj kërkesën sipas poz. 23 të ST/DT ashtu që në vend të dimensioneve fikseve që janë aktualisht të përcaktohet toleranca në dimensione si në vijim:

Dimensionet gjenerale Ø: 500 mm H: 820 mm (+/- 300 mm) V: 70 L (+/- 10L)
Pjesa nga betoni Ø: 500 mm H: 790 mm (+/- 50 mm) δ: 60 mm (+/- 5 mm)
Kapaku metalik: Ø: 500 mm H: 225 mm (+/- 120 mm) δ: 3 mm (+/- 1mm).

Po ashtu sa i përket formës së shportës kërkojmë nga AK që të ndryshoj/plotësoj kërkesën sipas poz. 23 të ST/DT ashtu që në kuadër të përshkrimit të pozicionit të shtohet fjalia si në vijim:

Kapaku i shportës duhet të ketë qasje për të tri (3) ndarjet në pjesën e brendshme të shportës dhe duhet të ketë mbishkrimin "GLASS", "PLASTIC" dhe "PAPER". Forma e kapakut mund të e ngjashme sikurse në foto apo ekuivalent.

Me shumë mirësjellje dhe respekt për AK, duhet të theksojmë që kërkesa si e tillë sipas poz. 23 të ST/DT është absolutisht diskriminuese dhe në kundërshtim të plotë me nenin 7 të LPP por edhe në kundërshtim me nenin 28 të LPP (pasi që nuk e lejon ekuivalencën). Prandaj nëse kërkesa jonë për rishqyrtim nuk do të miratohet, atëherë do të detyrohemi që të kërkojmë mbrojtje nga OSHP por edhe të shfrytëzojmë të gjitha mjetet tjera ligjore në dispozicion qofshin ato të natyrës civile apo penale. Kjo për arsye se nëse nuk miratohet kërkesa jonë si më sipër, atëherë AK po e konfirmon dyshimin tonë që ky aktivitet i prokurimit është përgatitur për një OE të caktuar dhe një veprim i tillë jo vetëm që është në kundërshtim me LPP por edhe me ligjet tjera në fuqi në shtetin tonë.

Lidhur me pretendimet ankimore, duhet cekur se përmes nenit 28 par. 7 të LPP thuhet se "7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët ose ekuivalent". Në rastin konkret parashtuesi ka argumentuar që poz. 23 në paramasë është përcaktuar me dimensione dhe me pamje fikse. Një formulim si i tillë është në kundërshtim të plotë me nenin 28 par. 7 lidhur me nenin 7 të LPP.

Për këtë arsye AK do të korrigjoj poz. 23 të ST/DT sipas propozimit të parashtuesit të prezantuar si në vijim:

Për këto arsye, kërkojmë nga AK që të ndryshoj/plotësoj kërkesën sipas poz. 23 të ST/DT ashtu që në vend të dimensioneve fikseve që janë aktualisht të përcaktohet toleranca në dimensione si në vijim:

Dimensionet gjenerale Ø: 500 mm H: 820 mm (+/- 300 mm) V: 70 L (+/- 10L)
Pjesa nga betoni Ø: 500 mm H: 790 mm (+/- 50 mm) δ: 60 mm (+/- 5 mm)
Kapaku metalik: Ø: 500 mm H: 225 mm (+/- 120 mm) δ: 3 mm (+/- 1mm).

Po ashtu sa i përket formës së shportës kërkojmë nga AK që të ndryshoj/plotësoj kërkesën sipas poz. 23 të ST/DT ashtu që në kuadër të përshkrimit të pozicionit të shtohet fjalia si në vijim:

Kapaku i shportës duhet të ketë qasje për të tri (3) ndarjet në pjesën e brendshme të shportës dhe duhet të ketë mbishkrimin "GLASS", "PLASTIC" dhe "PAPER". Forma e kapakut mund të e ngjashme sikurse në foto apo ekuivalent.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 19.01.2026

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.